



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

LICENCË

PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SIGURIMIT

Nr. 6/2001, datë 22.06.2012

Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare, në bazë dhe për zbatim të nenit 13 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare", të nenit 31 të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimi dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime", i ndryshuar, Autorizimit nr. 6 datë 13.09.2001, si dhe Vendimit nr. 83 datë 22.06.2012, të Bordit të AMF - së:

LICENCON

SHOQËRINË "INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP" SH.A.

"Për të ushtruar veprimtari sigurimi jo-jetë, në territorin e Republikës së Shqipërisë"

Licenca është e patransferueshme dhe e patregtueshme.

Vlefshmëria e licencës është me afat të pacaktuar.

Licenca është e vlefshme me aneksin bashkëngjitur.

Kjo licencë zëvendëson autorizimin nr. 6 datë 13.09.2001.



amf



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

ANEKS

LICENCA NR. 6/2001, DATË 22.06.2012 E SHOQËRISË "INTERSIG VIENNA
INSURANCE GROUP" SH.A.

Shoqëria e sigurimit "INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a, e regjistruar në QKR me NIPT K12201002T, në mbështetje të Lejes për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë në sigurime, nr. 6/1, datë 17.09.2001, do të ushtrojë veprimtari sigurimi jo-jetë, në këto klasa sigurimi:

- Klasa 1: Sigurimi i aksidenteve (përfshirë plagosjet industriale dhe sëmundjet profesionale)
- Klasa 2: Sigurimi i sëmundjeve
- Klasa 3: Sigurimi i mjeteve tokësore (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina)
- Klasa 4: Sigurimi i mjeteve lëvizëse mbi shina
- Klasa 5: Sigurimi i avionëve
- Klasa 6: Sigurimi i anijeve
- Klasa 7: Sigurimi i mallrave në transport (përfshirë mallra, bagazhe dhe të gjitha llojet e tjera të sendeve)
- Klasa 8: Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës (të ndryshme nga ato të përfshira në klasat 3, 4, 5, 6, dhe 7)
- Klasa 9: Sigurimi i dëmtimeve të tjera të pasurisë (të ndryshme nga ato të përfshira në klasat 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8)
- Klasa 10: Sigurimi i përgjegjësiave civile nga përdorimi i automjeteve mbi tokë (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit)
- Klasa 11: Sigurimi i përgjegjësiave civile nga përdorimi i avionëve (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit)
- Klasa 12: Sigurimi i përgjegjësiave civile nga përdorimi i anijeve (detare, të liqeneve dhe të lumëve, si dhe ato të kanaleve, përfshirë përgjegjësitë e transportuesit)
- Klasa 13: Sigurimi i përgjegjësiave civile të përgjithshme (përveç atyre të përfshira në klasat 10, 11 dhe 12)
- Klasa 15: Sigurimi i garancive



Enkelelda SHEHI
KRYETAR